

VENDIM
Nr. 163, datë 5.6.2026

**MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 199, DATË 15.8.2025, “MBI DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË
‘RENEW’ SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT
NDAJ ‘PROCREDIT BANK’ SHA”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1616/1 prot., datë 2.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 199, datë 15.8.2025, ‘Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘ProCredit Bank’ sh.a.’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Renew” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 199, datë 15.8.2025, ka miratuar dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a.

- Shoqëria ka plotësuar sa kërkuar në pikën 3, të vendimit nr. 199/2025, si e tillë kjo pikë është shfuqizuar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 264, datë 21.10.2025.

- Në kuadër të kushtit referuar pikës 4 të vendimit, me shkresën e fundit të përcjellë me nr. 1616 prot., datë 18.5.2026, shoqëria sqaron se ka shlyer totalin e financimit të marrë, ndaj ka depozituar deklaratën noteriale të bankës, datë 12.5.2026, me anë të të cilës është dhënë pëlqimi për heqjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë dhe zhblokimin e tyre nga çdo detyrim që rrjedh nga kontratat e nënshkruara. Gjithashtu, shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të QKB-së, nga shqyrtimi i të cilit rezulton/evidentohet se në datën 14.5.2026 është pasqyruar deklarata noteriale për heqjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë të vendosura mbi bazën e kontratës nr. 740 rep., nr. 437 kol., datë 19.3.2025.

- Për gjithë sa më sipër, për sa kërkuar nga vetë subjekti, e në rrethanat që arsyeja kryesore për të cilën është dhënë ky autorizim ka rënë, si dhe në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësojmë se jemi në rrethanat e shfuqizimit të vendimit nr. 199, datë 15.8.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘ProCredit Bank’ sh.a.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 199, datë 15.8.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj ‘ProCredit Bank’ sh.a.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k., “ProCredit Bank” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti